



Zyra e kryetarit të komunës

Vushtrri, më 19.02.2013

Nr.205/13

Në mbështetje nenit 18 paragrafi 1 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr.03/L-149, në bazë të nenit 3 të Rregullores për rekrutimin, nr.02/2010 dhe në bazë të vendimit, nr.204/13, Kryetari i komunës, shpall:

K O N K U R S

Për vendin e punës:

Zyra ligjore e komunës

I.Vendi i punës:**Udhëheqës i zyrës ligjore-përfaqësues ligjor i komunës**

Numri i ekzekutuesve një(1)

Përshkrimi i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësi

- Përfaqëson komunën në të gjitha kontestet civile, penale dhe administrative;
- Ushtron padi, përgjigjet në padi dhe veprime tjera në të gjitha instancat gjyqësore në Kosovë (gjykata të rregullta) dhe ndërmerr veprime të nevojshme për mbrojtje të interesit të komunës;
- Jep mendime profesionale ligjore lidhur me kontratat, marrëveshjet dhe aktet tjera që lidhen në mes të komunës dhe organeve, institucioneve dhe personave tjerë fizik dhe juridik;
- Ushtron mjete të rregullta dhe të jashtëzakonshme juridike;
- Jep mendime juridike profesionale, udhëzime dhe rekomandime tjera në përmbushje të ligjshmërisë, sa i përket punës së organeve komunale;
- Për punën e vet i përgjigjet kryetarit të komunës.

Kualifikimi profesional, aftësitë:

-Fakulteti juridik;

-Përvojë pune: 5(pesë) vite në profesion-administratë publike

-Trajnime të ndryshme nga fusha e administratës publike ose shërbimit civil

-Njohja e mirë e punës në kompjuter në programet word ,exel;

Kategoria funksionale:Drejtuese

Lloji i vendit të punës: **Nëpunës i karrierës**

Koeficienti i pagës 9.5

Periudha e provuese;një(1) vit .

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informacionit publik.

-Paraqitja e kërkesave:

Aplikacionet mund të merren në Zyrën e pranimit ose në faqen e internetit të komunës www.kk.rks-gov.net/vushtrri dhe pastaj dorëzohen në Zyrën e pranimit. Aplikacionit duhet t'i bashkangjesin: **Kopjen e vërtetuar të Diplomës, kopjen e letërnjoftimit dhe certifikatën e lindjes, certifikatën që nuk është i dënuar dhe nën hetime, certifikatën mbi njohjen e**

punës në kompjuter, si dhe certifikata tjera mbi trajnimet,të jetë banor i Republikës së Kosovës.

Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen. Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhjen e ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor. Për çdo informacion kandidatët mund të drejtohen në Njësinë e personelit (zyra numër 8),nr. i tel. 028-572-416.

Shërbimi Civil i Kosovës i shërben të gjithë popullit të Kosovës, dhe mirëpret aplikacionet prej meshkujve dhe femrave prej të gjitha komuniteteve të Republikës së Kosovës.

**Kryetari i komunës
Bajram Mulaku**